



This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Të dashur qytetarë,

Ju prezantojmë me këtë broshurë që ka për qëllim t'ju paraqesë një politikë të re të menaxhimit të mbetjeve, e cila do të zbatohet në Bashkinë e Beranes në Mal të Zi dhe në Bashkinë Malësi e Madhe në Shqipëri.

Broshura synon t'ju njohë me avantazhet dhe dobitë e sistemit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve sepse, siç e dini, shumica e mbetjeve mund të bëhet një lëndë e parë e dobishme për marrjen e produkteve të reja. Grumbullimi i ndarë i mbetjeve në familje është një praktikë e zakonshme në vendet e zhvilluara të botës.

Sigurisht, nuk është e nevojshme të theksojmë në mënyrë të veçantë faktin që duke vepruar kështu e bëjmë qytetin tonë më të pastër, më të shëndetshëm dhe më të bukur.

Prandaj, ju bëjmë thirrje që të merrni pak kohë për ta lexuar broshurën dhe kështu ju rikujtoni edhe një herë disa fakte në lidhje me grumbullimin e ndarë të mbetjeve.

Pse duhen ndarë mbetjet sipas tipologjisë së tyre?

- sepse mbetjet përmbajnë shumë materiale të dobishme të tilla si letër, plastikë, metal, qelq dhe të tjera që mund të përpunohen (riciklohen) dhe përdoren për të prodhuar materiale të reja;
- sepse është e nevojshme për të nxjerrë më vete përbërësit/lëndët e rrezikshme nga mbetjet, siç janë bateritë e vjetra, barnat, pajisjet elektronike, bojërat dhe verniqet etj. Këta përbërës të rrezikshëm duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë për të shmangur ndotjen e mjedisit;
- sepse është e nevojshme të mbajmë shfrytëzimin ekonomik të hapësirës së vend-depozitimit (deponisë) në mënyrë që të mos hapen vende të reja vend-depozitimesh të mbetjeve.

Çfarë bëjmë ne të mundur në këtë mënyrë?

- ne reduktojmë shpejtësinë e shfrytëzimit të resurseve natyrore të destinuara për brezat e ardhshëm (ne duhet ta kemi gjithmonë parasysh dhe në vëmendje këtë!);
- mundësojmë një mjedis më të pastër dhe më të sigurt - toka, uji dhe ajri;
- mundësojmë një qytet më të pastër dhe më të rregullt.

Sa mund të kontribuoni Ju?

Shumë!

Imagjinoni se sa mbetje të dobishme do të mblidheshin dhe sa burime natyrore do të ruheshin, nëse çdo qytetar i bashkive tona do të grumbullonte së paku 1 kg letër, 1 kg plastikë, 1 kg metal dhe 1 kg qelq gjatë një periudhe kohore prej një muaji.

Vetëm një muaj i shpenzuar për grumbullimin e kaq shumë letre do të kontribuonte në shmangien e prerjes së 120 pemëve, riciklimi i plastikës do të kursente tonelata e tonelata naftë, shumë kanaçe të reja do të bëheshin prej metali, dhe gjithashtu makinat, pajisjet shtëpiake dhe shumë produkte të tjera, dhe aq shumë qelq do të kursenin deri në 42 ton rërë, 12 ton gëlqerorë dhe 12 ton sodë.

Sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe ujit do të kurseheshin në këtë mënyrë, dhe kjo është vetëm një pjesë e historisë për dobitë e riciklimit.

Në periudhën në vijim, në Bashkitë tona do të krijohet një sistem i ri i grumbullimit të ndarë të mbetjeve.

Në këtë mënyrë ju do të keni mundësinë të tregoni vetëdijen tuaj ekologjike dhe etjen dhe dëshirën për të kontribuar në ruajtjen e pastërtisë së Bashkisë dhe mjedisit tuaj!

SISTEMI I GRUMBULLIMIT TË NDARË TË MBETJEVE

Në mënyrë që të krijohet një sistem sa më efikas i grumbullimit të ndarë të mbetjeve në Bashkinë tonë, vendosëm vënien në zbatim të dy modeleve.

Modeli i parë përfshin instalimin e disa koshave (kontenierëve) për depozitimin e përbërësve (lëndëve) të mbetjeve të thata: metalet, qelqi, plastika dhe letra; dhe sistemi i dytë përfshin instalimin e dy koshave (kontenierëve) për depozitimin e përbërësve (lëndëve) të mbetjeve të thata dhe të njoma.

„SISTEMI I KATËR KOSHAVE“

LETËR/KARTON, METAL, PLASTIKË, QELQ



„SISTEMI I DY KOSHAVE“

MBETJE TË NJOMA: mbetje bashkiake të përziera (të pandara), mbetje nga ushqimi, mbetje nga kopshtet e shtëpive, mbeturina, pelena.....

MBETJE TË THATA: letër, karton, metal, plastikë, qelq.....



„SISTEMI I KATËR KOSHAVE“

LETËR DHE KARTON



Mendoni për këtë! Letra dhe kartoni përbëjnë më shumë se 20% të mbetjeve shtëpiake. Është e mundur që të riciklohen disa herë, dhe kështu mund të kontribuojnë në kursimin e ujit, energjisë dhe lëndës së parë të drurit.

Le të ndryshojmë zakonet tona! Hidhni letrën e vjetër në një kosh (kontenier) të emërtuar LETËR dhe kontribuoni për një ndryshim pozitiv.


PO!

- ✓ gazeta dhe letra zyre
- ✓ revista, katalogë, broshura, fletore, blloqe shënimesh
- ✓ paketime letre dhe kartoni

JO!

- ✗ paketime tetrapak
- ✗ letra të plastifikuara
- ✗ letra metalike

PLASTIKË



Mendoni për këtë! Paketimi plastik përbën rreth 12% të mbetjeve shtëpiake. Plastika gjithashtu mund të riciklohet dhe kështu të kontribuojë në kursimin e naftës. Sasia e këtij burimi në Tokë po zvogëlohet dhe nëse vazhdojmë në këtë mënyrë, nuk do të jetë e mjaftueshme për brezat e ardhshëm, fëmijët tanë, nipërit e mbesat, stërnipërit ...

Le të ndryshojmë zakonet tona! Hidhni paketimin plastik në një kosh (kontenier) të emërtuar PLASTIKË dhe kontribuoni për një ndryshim pozitiv.

PO!

- ✓ paketime detergjentësh
- ✓ paketime shamposh
- ✓ paketime produktesh ushqimore

JO!

- ✗ lodra plastike

METAL



Mendoni për këtë! Paketimi metalik përbën rreth 4% të mbetjeve shtëpiake. Produktet metalike gjithashtu mund të riciklohen dhe kështu të kontribuojnë në ruajtjen e metaleve të vlefshme natyrore. Mbetjet metalike të ripërdorura zëvendësojnë nevojën për përdorimin e lëndëve të para në industrinë metalike. **Le të ndryshojmë zakonet tona!** Hidhni paketimin metalik në një kosh (kontenier) të emërtuar METAL dhe kontribuoni për një ndryshim pozitiv.

PO!

- ✓ paketime të produkteve ushqimore
- ✓ kanaçe, kuti prej kallaji, kapakë metalikë

JO!

- ✗ paketime kimikatesh të forta dhe substancash të ndezshme
- ✗ paketime llaqesh/spërkatësish
- ✗ paketime bojërash dhe verniqesh

QELQ



Mendoni për këtë! Qelqi përbën rreth 5% të mbetjeve shtëpiake. Ai mund të riciklohet tërësisht pafundësisht pa e humbur cilësinë e tij. Megjithatë, tonelata e tonelata të kësaj lënde të vlefshme të parë përfundojnë në vend-depozitime (deponi).

Le të ndryshojmë zakonet tona! Hidhni paketimin e qelqit në një kosh (kontenier) të emërtuar QELQ dhe kontribuoni për një ndryshim pozitiv.

PO!

- ✓ shishe qelqi dhe kavanoza në të gjitha ngjyrat
- ✓ syzet

JO!

- ✗ dritare, qelqe nga materiale mjekësore dhe makinash
- ✗ paketime kimikatesh të forta dhe substancash të ndezshme
 - ✗ kristal, pasqyra
 - ✗ llamba, llamba neoni

„SISTEMI I DY KOSHAVE“

Përveç ndarjes së përbërësve (lëndëve) të mbetjeve të thata duke zbatuar „sistemin e katër koshave“, qytetarët gjithashtu mund të ndajnë mbetjet e njoma dhe të thata duke zbatuar një sistem i cili kërkon vetëm dy kosha (kontenierë).

MBETJE TË THATA:

letër, karton, metal, plastikë, qelq.....

MBETJE TË NJOMA:

mbetje bashkiake të përziera (të pandara), mbetje nga ushqimi, mbetje nga kopshtet e shtëpive, mbeturina, pelena....



Në fund, bashkëqytetarët tanë të dashur, duke zbatuar sistemin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve, ne do të zvogëlojmë sasinë e mbetjeve që përfundojnë në koshat (kontenierët) e mbetjeve të përziera dhe për rrjedhojë do të zvogëlojmë sasinë e mbetjeve të hedhura në vendet/vend-depozitimet e përkohshme të mbetjeve, dhe më e rëndësishmja, ne do të reduktojmë ndikimin negativ në mjedis.

Projekt i zbatuar nga:



Bashkia Berane



VIS Albania



Bashkia Malësi e Madhe



Caritas Montenegro



Projekti “Green Lands” (“Ishujt e Gjelbër”) është duke u zbatuar në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020. Qëllimi i projektit është krijimi i një sistemi efikas dhe të integruar të grumbullimit të mbetjeve në Bashkitë Berane dhe Malësi e Madhe, me qëllim që të kontribuohet në një mbrojtje më të mirë mjedisore dhe të sigurohet një përfshirje e vazhdueshme e pjesëmarrësve të ndryshëm. Zbatimi i aktiviteteve që përfshijnë grumbullimin, riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve në nivel individual dhe publik është një qasje konkrete që synon të ndikojë në ndryshimin e qëndrimit të qytetarëve dhe institucioneve ndaj problemit të mbetjeve dhe ndotjes.



Kjo broshurë është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj mbetet përgjegjësi e vetme e Bashkisë Berane, Bashkisë Malësi e Madhe, VIS Albania dhe CARITAS Mal i Zi dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.